

23 Tetor, 2009

Hapet Zyra Turistike në Pogradec

Ngritja e Zyrës së Informacionit të Turizmit në Pogradec përmes një Partneriteti Publiko-Privat si një mënyrë për promovimin e turizmit, duke i ofruar publikut një shërbim dhe informacion turistik në mënyrë profesionale dhe falas

Aktiviteti mbledhi sot në Zyrën e Informacionit të Turizmit në Pogradec përfaqësues të Bashkisë së Pogradecit, të USAID, Ministrisë së Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, projekteve donatorë që operojnë në zonë, biznese turistike të qytetit dhe shumë qytetarë. Ceremoninë e përshëndetën, z. Artan Shkëmbi, Kryetar i Bashkisë së Pogradecit, z. James Berschaeit, përfaqësues i USAID në Shqipëri dhe znj. Nada Kallciu, Drejtore e Agjencisë së Turizmit, pranë Ministrisë së Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.

Bashkia e Pogradecit inaguron sot Zyrën më të re të Informacionit të Turizmit, duke e vlerësuar si një faktor shumë të rëndësishëm për nxitjen dhe zhvillimin e turizmit, si një burim kryesor për punësimin dhe zhvillimin ekonomik të qytetit.

Iniciativa është një shembull konkret i një partneriti publiko-privat mes Bashkisë së Pogradecit dhe kompanisë Çelësi, me mbështetjen edhe të USAID.

Kompania Çelësi ka marr përsipër jo vetëm pajisjen e zyrës, punësimin e stafit, por edhe menaxhimin dhe mbarëvajtjen e Zyrës së Informacionit të Turizmit (ZIT) me shpenzimet e saj. Çelësi ka eksperiencë në ofrimin e shërbimit për informacionin turistik në Shkodër, si dhe në Vlorë e Sarandë. Bashkia përfiton nga ky shërbim pa paguar asnjë kosto. Në këmbim të kësaj,

Bashkia siguroi vendin dhe godinën e nevojshme për ZIT, e cila do të bëjë të mundur transformimin dhe përmirësimin e një sektori të rëndësishëm të ekonomisë së qytetit, si dhe do të jetë një instrument për rritjen e investimeve private dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik vendor. Në ceremoninë e organizuar sot morën pjesë kryetari i bashkisë Pogradec, përfaqësues të USAID, të Çelesit, operatorë turistik lokale dhe kombëtarë, media dhe të interesuar të tjerë.